

**LIGJ**  
**Nr. 76/2024**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 61/2012, “PËR AKCIZAT  
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

**Neni 1**

Në nenin 40, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Pulla fiskale është dokument me vlerë dhe është monopol shtetëror. Këshilli i Ministrave me vendim përcakton elementet e sigurisë së pullave fiskale, si dhe personin e autorizuar juridik publik për prodhimin, shpërndarjen, si dhe ngritjen e sistemit për gjurmimin dhe kontrollin e tyre”.

**Neni 2**

Në nenin 41, pika 8, shkronja “d”, hiqen fjalët “me koncesionarin”.

**Neni 3**

Në nenin 42 bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

“1. Çmimi për çdo pullë fiskale të prodhuar dhe të shpërndarë nga personi i autorizuar juridik publik përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Të gjithë prodhuesit dhe importuesit, të cilëve sipas ligjit u kërkohet të aplikojnë pullën fiskale, i paguajnë personit të autorizuar juridik publik çmimin e pullave të përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni.”.

2. Në pikën 3 fjala “koncesionarin” zëvendësohet me fjalët “personin e autorizuar juridik publik për prodhimin dhe shpërndarjen e pullave fiskale”.

**Neni 4**

Në nenin 109 pas pikës 8 shtohet pika 9 me këtë përmbajtje:

“9. Pullat fiskale të porositura tek kompania koncesionare dhe të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave deri më 31.12.2024 lejohen të dërgohen tek prodhuesi apo furnizuesi deri në datën 31 mars 2025.

Produktet e akcizës, në të cilat janë trupëzuar pullat fiskale të porositura tek kompania koncesionare e të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave deri më 31.12.2024, do të lejohen të hidhen për konsum brenda 1 viti nga data e dërgimit të pullës fiskale tek prodhuesi apo furnizuesi.”

**Neni 5**

Shtojca 2 “Çmimi (duke përjashtuar TVSH-në dhe çdo taksë tjetër apo detyrime pulle të aplikueshme, sipas ligjit shqiptar) për çdo pullë fiskale individuale të prodhuar dhe të shpërndarë nga koncesionari” shfuqizohet.

## Neni 6

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda një periudhe 3-mujore nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim neneve 1 dhe 3 të këtij ligji.

## Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2025.

Miraturar në datën 26.7.2024.

**Shpallur me dekretin nr. 281, datë 1.8.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bajram Begaj.**

